



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:116581

Datë: 30.12.2022

Numri i dokumentit: 03815826

P.nr. 10/06

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË–Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Gëzim Ademi, me bashkëpunëtoren profesionale Medina Rama, në çështjen penale kundër te pandehurit A.B, për shkak te dyshimit të kryerjes së veprës penale “Falsifikim i parasë” nga neni 244 par.1 te KPK-së, sipas aktakuzës se Prokurorisë Publike të Qarkut, PP.nr.205/05, dt.16.01.2006, e ri cilësuar nga prokuroria ne veprën penale “Falsifikim i parasë” nga neni 244 par.3 të KPK-së, e në mbështetje të nenit 358 te Kodit te Procedurës Penale, jashtë shqyrtimit gjyqësor, duke vendosur sipas detyrës zyrtare me dt. 30.12.2022, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

- 1. HUDHET** akuza e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovice, PP.nr.205/05, dt.16.01.2006, **si dhe Pushohet procedura penale** kundër të pandehurit: **A.B**, i lindur me ..., në fshatin ..., komuna e Mitrovicës, ku edhe jeton për veprën penale; Falsifikim i parasë nga neni 244 par.3 te KPK-së. Akuza hedhet për shkak se Prokuroria Themelore ne Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda nëpërmjet shkresës PP.I.nr.205/2005 te datës 23.12.2022, është tërhequr nga ndjekja e mëtejme penale ndaj te pandehurit A.B.
2. Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.
3. Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.
4. **-Në mbështetje të nenit 282 të KPP-ës;**
URDHËROHET – Konfiskimi i përhershëm i kartëmonedhës prej 200 € euro, me numër serik: Y00011161774, e cila ishte sekuestruar përkohësisht, e njëjta pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzë PP.nr.205/05, dt.16.01.2006, kundër te pandehurit A.B, i lindur me datën 04.07.1980 ne fshatin ..., komuna e Mitrovicës, ku edhe jeton, për shkak te veprës penale Falsifikim i parasë nga neni 244 par.1 te KPK-së.

Prokuroria Themelore ne Mitrovice-Departamenti i Krimeve të Rënda nëpërmjet shkresës PP.I.nr.205/2015, dt.23.12.2022, e ka njoftuar gjykatën se tërhiqen nga ndjekja e mëtejme penale për te pandehurin A.B nga Mitrovica, duke i propozuar gjykatës që te hedh akuzën dhe te pushoj procedurën penale ndaj te pandehurit, sepse pasi që ka bërë ri-kualifikimin juridik të veprës penale nga neni 244 par.1 të KPK-së, në nenin 244 par.3 të KPK-së, i cili parashihte dënimin me gjobë apo dënimin me burgim deri në një vit. Duke e pasur parasysh që vepra penale dyshohet të jetë kryer me datë 18.01.2005, në këtë rast ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, nga këto arsye Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda ka hequr dorë nga aktakuza dhe ndjekja penale ndaj te pandehurit A.B, si dhe i ka propozuar gjykatës që të bëjë konfiskimin e parasë së falsifikuar gjegjësisht kartëmonedhës prej 200 € euro, me numër serik: Y00011161774.

Gjykata, pasi ka pranuar njoftimin e Prokurorisë për tërheqjen nga akuza PP.nr. 205/2015 te datës 16.01.2006, ndaj te pandehurit A.B, i lindur në fshatin ..., komuna e Mitrovicës, ku edhe jeton, për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale Falsifikim i Parasë nga neni 244 par.3 te KPK-së, vlerëson se Prokuroria e Shtetit ne PTH-ne Mitrovice, si organ i ndjekjes ka te drejte ligjore që ne çdo kohe te tërhiqet nga ndjekja penale, deri ne përfundimin e shqyrtimit gjyqësorë. Meqenëse, prokuroria është tërhequr nga ndjekja penale dhe procedura penale nuk mund te vazhdoje me tutje ne mungese te akuzës, nga këto arsye gjykata konsideron se janë plotësuar ne tërësi kushtet ligjore për hedhjen e akuzës dhe pushimin e procedurës penale ndaj te pandehurit A.B, andaj nga këto arsye ka nxjerrë edhe aktvendim ne mbështetje te nenit 358 te Kodit te Procedurës Penale te Kosovës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka nxjerrë ne përputhje me nenin 454 te KPP-ës.

Vendimi mbi konfiskimin e kartëmonedhës në vlerë prej 200 (dyqind) euro, u morr në përputhje me nenin 282 të KPP-së.

Nga sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Krimeve të Rënda
P.nr.10/06, dt.30.12.2022

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:
Gëzim Ademi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh, nga momenti i pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës se Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.